

Tejkalohe afati ligjor për mbledhjet e Këshillit Komunal të Sigurisë

Arian Duriqi

LIPJAN, 9 TETOR – Saktësisht dhjetë muaj, me vetëm tri mbledhje të mbajtura. Funksionimi i Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi (KKS) ka marrë në thua për faktin se nuk janë përmbushur afatet ligjore për mbledhjet e këtij organi të rëndësishëm për sigurinë e kësaj komune. Mbledhja e fundit e KKS-së në Lipjan dhe vetëm e treta për këtë vit ishte mbajtur më 23 korrik, derisa nga ajo kohë mbledhje tjetër nuk është mbajtur, ndërsa parashihet që së paku një herë në dy muaj të mbledhet KKS-ja për të rrumbullakuar numrin prej 6 mbledhjesh brenda një viti. Të enten me gjithë përpjekjet nuk ka qenë e mundur të merrej një prononcim zyrtar nga autoritetet komunale për këtë punë, ndërsa reagim ka pasur nga shoqëria civile. Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në OJQ-në YAHR, ka thënë me këtë rast se Lipjani ka lënë anash punën e KKS-së dhe ka devijuar afatet ligjore për mbajtje mbledhjesh.



Madje, sipas tij, ka dështuar edhe takimi me qytetarë që duhej ta mbante KKS-ja gjatë pjesës së parë të këtij viti. Por, sipas Krasniqit, ashtu edhe siç ishte ngritur me bishtnime ky organ, në fillimin e këtij viti ashtu edhe po funksionon. Ky ka deklaruar njëherësh se ky

organ ishte ngritur pa konsulta të nevojshme me kandidatët e mundshëm për përbërjen e kërkuar me udhëzim administrativ. "Në të vërtetë ky organ ishte themeluar pa konsulta paraprake me njerëzit potencialë për të qenë pjesë e KKS-së. Ishte një dekret i kreut komunal

se kush duhet të jetë pjesë e këtij organi dhe si i tillë ishte votuar. Për shembull, në pozitën ku do të shkonte një person nga handikapët, shoqëria civile e mediet, ka shkuar një njeri nga shoqëria civile që është i pëlqyer i pushtetit dhe për këtë propozim nuk janë konsultuar as

handikapët, as shoqëria civile e as gazetarët. Dhe mbi këtë bazë linden dyshime të mëdha se kryetari kësaj here pati vepruar fshehtas", ka thënë Krasniqi. Megjithatë, ky edhe pse ka kundërshtime në këtë plan për vetë themelimin e KKS-së, ka shtuar se megjithatë pushteti lokal duhet të mendojë ta rifunksionalizojë atë për faktin se është një organ që ka peshën e vet në çështjet e sigurisë. Ndërkohë që një kritikë për mosfunksionimin e drejtë të këtij organi e kanë dhënë të enjten edhe një pjesë e opozitës së kësaj komune.

Ramiz Qeriqi, këshilltar nga PSD-ja, ka thënë se KKS-ja është votuar në KK për të funksionuar dhe jo për të dështuar. "Duhet të vihet një praktikë që organet, të cilat votohen për funksionimin në KK të jenë aktive dhe jo pasive. KKS-ja është dashur të përmbushte afatet ligjore të takimeve, ndërsa ne do të kërkojmë sqarime në mbledhjen e ardhshme të KK-së për këtë ngërç që e ka kapluar këtë organ", ka thënë ai.

© KOHA Ditore

D... për korrupsionin në nezullim zyrtarin në naga